



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 7008 Prot.

Koplik, me 11/11/2024

V E N D I M

NR 64 DATË 06 / 11 / 2024

PËR

**“ TRANSFERIM FONDI PËR ZBATIMIN E MARREVESHJES SË BASHKEPUNIMIT
NDERMJET BASHKISË MALESI E MADHE DHE ZONE NAGE ME ADRESE: CHAUSSEE DE
LIEGE 55-5100 JAMBES (NAMUR) “**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 06/11/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbeshtetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore “në ligjin 97/2023 “Për buxhetin e Shtetit të vitit 2024“ të ndryshuar, në Vendimin e KB nr.6 datë 18.01.2024, “Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Malësi e Madhe“, në ligjshmerine e prefektit Qarkut Shkodër me nr. prot.105/1 ,datë 24.01.2024 ,në Marreveshjen e Bashkepunimit nr.2609 prot.datë 15/10/2024 nenshkuar ndermjet Bashkise Malësi e Madhe dhe Zone Nage me adrese :Chaussee de liege 55-5100 Jambes (Namur),

V E N D O S I

1. Transferimin e fondit me shumën totale 500,000 lekë spas tabelës bashkëlidhur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

1. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 06.11.2024

Vota Pro 16

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 07.11.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E FINANCES DHE BUXHETIT
SEKTORI I BUXHETIT

Nr 7609/Prot.
1

Koplik, me 31/10/2024

PROJEKT-VENDIM

NR ____ DATË ____/____/2024

PER

“ TRANSFERIM FONDI PER ZBATIMIN E MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT NDERMJET BASHKISE MALESI E MADHE DHE ZONE NAGE ME ADRESE:CHAUSSEE DE LIEGE 55-5100 JAMBES (NAMUR)“

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dates ____/____/2024 me propozim te kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne ligjin nr.9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar, ne ligjin nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore”, te ligjit nr.68/2017“Per Financat e veteqeverisjes Vendore “ne ligjin 97/2023 “Per buxhetin e Shtetit te vitit 2024“ te ndryshuar , ne Vendimin e KB nr.6 date 18.01.2024, “Per Miratimin e Buxhetit te vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesem 2024-2026 te Bashkise Malesi e Madhe”,ne ligjshmerine e prefektit Qarkut Shkoder me nr. prot.105/1 ,date 24.01.2024 ,ne Marreveshjen e Bashkepunimit nr.2609 prot.date 15/10/2024 nenshkruar ndermjet Bashkise Malesi e Madhe dhe Zone Nage me adrese :Chaussee de liege 55-5100 Jambes (Namur),

PROPOZOJ

- 1.Transferimin e fondit me shumen totale 500,000 leke spas tabeles bashkelidhur projektit,
- 2.Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise.
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALESË E MADHE

Nr 2609 Prot

Koplik, më 15 / 10 .2024

MARRËVESHJE BASHKEPUNIMI
(AKT DHURIMI)

Ndërmjet

- **ZONE NAGE** me Adresë:Chaussee de Liege 55-5100 Jambes (Namur), Celular: 081325200, E-Mail: pierre.bocca@zone-nage.be numero d'enterprise 0500.926.608. Përfaqësuar nga Pierre Bocca Colonel De Zone (këtu e tutje referuar si **dhuruesi**) dhe
- **Bashkia Malësi e Madhe** Koplik Qendër, përfaqësuar nga Kryetari, z. Tonin Marinaj (këtu e tutje referuar si **përfituesi**).

(Bashkarisht referuar si 'Palët')

Baza ligjore

-Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

-Ligji nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"

Neni 1

Objekti i Dhuratës

Objekti i kësaj dhurate është një makinë zjarrfikëse si më poshtë:

Lloji i mjetit : Zjarrfikëse

Marka: IVECO Magirus

Nr.i Shasise : ZCFA1LLH002198460

Data e prodhimit: 02/03/1998

Targa :1 NXB 382

Kilometrazhi: 105.600 KM



Neni 2

Qëllimi i dhuratës

Qëllimi i dhuratës është përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve dhe paisjeve të Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të Bashkisë Malësi e Madhe, në përgjigje të situatave të emergjencës civile dhe zbatimit të masave të zjarrfikeses.

Neni 3

Vlera dhe perfituesi perfundimtar

Makina dhe paisjet e dhuruara do të dhurohen pa asnjë detyrim për perfituesin.

Perfituesi i makines dhe paisjeve do të jetë:

- Pronësia: Bashkia Malësi e Madhe, Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ;
- Vendi i dorëzimit: Bashkia Malësi e Madhe.

Neni 4

Mirëmbajtja

Nga momenti i dorëzimit të mjetit dhe paisjeve tek perfituesi, dhuruesi nuk ka më asnjë përgjegjësi në mirëmbajtje si dhe asnjë shpenzim tjetër në lidhje me dhuraten. Perfituesi është përgjegjës për rregjistrimin, sigurimin dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes për të siguruar funksionimin e mjetit.

Neni 5

Detyrimet e palëve

Bashkia Malësi e Madhe do të ndermarrë të gjitha procedurat e nevojshme të lidhura me importin e mjetit, si dhe mundësisë së përjashtimit të detyrimit doganor.

Bashkia Malësi e Madhe do të mbulojë shpenzimet në Shumen prej 5000 euro, në mënyrë që të sigurohet transporti i mjetit në Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të Bashkisë Malësi e Madhe .

Shoqata “Nënë Tereza” merr përsipër transportimin e mjetit deri ne vendin e dorëzimit duke mbuluar shpenzimet e transportit, kosto të ndryshme udhëtimi dhe biletat e kthimit për ekuipazhin brenda shumës 5000 euro sipas autorizimit të **ZONE NAGE**.

Vlera e mesiperme do të konvertohet në Leke sipas kursit të kembimit të valutes ditën e likuidimit të detyrimit sipas kësaj kontrate.

Vlera do të kalohet përmes llogarisë bankare të Shoqatës Nënë Tereza nga Bashkia Malësi e Madhe:

Account Number: BE63 7512 0811 0308

Neni 6

Ndryshimet

Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje do të bazohen në mirekuptimin me shkrim nga të dyja palët



Neni 7

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin apo lidhen me interpretimin ose zbatimin e këtij akti.

Në rastin kur palët dështojnë në zgjidhjen me mirëkuptim, mosmarrëveshja do t'i referohet arbitrazhit, nga njëra palë kontraktuese për zgjidhjen e saj me rregullat e arbitrazhit UNCITRAL që janë në fuqi në datën e referimit të mosmarrëveshjes në arbitrazh. Numri i arbitrave duhet të jetë 1 (një). Palët duhet të bien dakord për vendin e arbitrazhit. Gjuha e arbitrazhit duhet të jetë Anglisht. Vendimet e arbitrit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për palët.

Neni 8

Dispozita kalimtare

Deklarata është bërë më ___ tetor 2024, në 6 (gjashtë) kopje – 3(tre) në Shqip dhe 3 (tre) në Anglisht dhe janë të vlefshme të gjitha. Në rastet e mosmarrëveshjeve, versioni anglisht i këtij akti do të prevalojë.

Dhuruesi

ZONE NAGE

Perfaqësues

PIERRE BOCCA

COLONEL DE ZONE

Colonel Pierre BOCCA
Commandant de zone
ZONE DE SECOURS NAGE

Perfituesi

BASHKIA MALËSI E MADHE

KRYETAR

Tonin Marinaj

